



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.616/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.31/2018 të datës 23.01.2018 të ankuesit ankesën me

numër A.nr.37/2018 të datës 26.01.2018 të parashtruar nga ankuesja

ankesën me numër A.nr.60/2018 të datës 08.02.2018 të parashtruar nga ankuesja

dhe ankesën me numër A.nr.61/2018 të datës 08.02.2018 të parashtruar nga ankuesi

të cilat në bazë të Vendimin VK.Nr.70/2022 të datës 08.08.2022 të Kryetarit të

Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë bashkuar në një ankesë, kundër organit të punësimit/Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.31/2018 e datës 23.01.2018 e ankuesit ankesa me numër A.nr.37/2018 e datës 26.01.2018 e parashtruar nga ankuesja ankesa me numër A.nr.60/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesja dhe ankesa me numër A.nr.61/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesi

II. **NDRYSHOHET** Vendimi me Nr.01/2018 i datës 10.01.2018 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe Njoftimi për kandidatët e suksesshëm i datës 11.08.2017 i shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për proceduarën e rekrutimit për pozitën Inspektor Tatimor 30 pozita.

III. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Administratës Tatimore të Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike më datë 09.06.2017 ka lëshuar Autorizim për shpalljen e konkursit nga Administrata Tatimore e Kosovës për pozitën Inspektor Tatimor-INS.23.JP00028736. Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të këtij autorizimi, me datë 13.06.2017 ka shpallur konkursin për pozitën, "Inspektor tatimor (30) pozita" me numër reference INS/230/JP00028736, ndërsa në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Administrata Tatimore e Kosovës më datë 11.08.2017 ka publikuar Njoftimin për Kandidatët e Suksesshëm, ndërsa rezultoni se ankuesit nuk janë kandidatë të suksesshëm. Ankuesi kundër këtij njoftimi kanë parashtruar ankesë të brendshëm në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, pastaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Fillimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka bashkuar ankesat e ankuesve dhe më datë 22.12.2017 ka nxjerr Vendim A/02/667/2017 me të cilin ka shfuqizuar vendimet e nxjerre nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, duke e obliguar të njëjtin ti rishqyrtoj ankesat e ankuesve lidhur me këtë procedurë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 10.01.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/2018 me të cilin ka refuzuar ankesat e ankuesve, ndërsa ankuesit kundër këtij vendimi kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në bazë të Vendimit A.nr31/2018 të datës 29.01.2018, Vendimit A.nr.37/2018 të datës 14.03.2018, Vendimin A.nr.60/2018 të datës 06.04.2018 dhe Vendimin A.nr.61/2018 të datës 26.02.2018 ka aprovuar ankesat e ankuesve duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 01/2018 të datës 10.01.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës, e pakënaqur me vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Nëse gjykatat kanë aprovuar kërkesën për shtyrje të zbatimit të vendimeve të Këshillit. Lidhur me vendimin e Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankueses dhe fillimisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.489/2018 të datës 05.03.2020 respektivisht Aktgjykimin A.nr.410/2018 të datës 03.03.2020 është refuzuar kërkesëpadia e Administratës Tatimore të Kosovës dhe janë vërtetuar vendimet e Këshillit, ndërsa sipas Aktgjykimin AA.nr.401/20 dhe Aktgjykimin AA.nr.402/20 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, janë aprovuar ankesat e palëve të interesuar duke u anuluar aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe vendimet e Këshillit dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:337/2018 të datës 23.01.2018 të ankuesit

ankesën me Nr. Prot: 398/2018 e datës 26.01.2018 e parashtruar nga ankuesja
ankesën me Nr. Port: 716/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesja
dhe ankesën me Nr. Port: 718/2018 e datës 08.02.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.31/2018 të datës 29.01.2018, Vendimin A.nr.37/2018 të datës 14.03.2018, Vendimin A.nr.60/2018 të datës 06.04.2018 dhe Vendimin A.nr.61/2018 të datës 26.02.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për rastin e ankuesve; Vendimin me Nr.01/2018 të datës 10.01.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës; Njoftimin e datës 11.08.2017 për kandidatët e suksesshëm; Konkursin e datës 13.06.2017 të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës për pozitën Inspektor Tatimore 30 pozita; Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigjen në ankesë e dërguar nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me të gjitha dokumentacionet përkatëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka rishqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe duke u bazuar në Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar që ankesa e ankuesve, ***është e pjesërisht e bazuar, SEPSE:***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative,

ka rishqyrtuar të gjitha provat e lëndës respektivisht aplikacionet e kandidatëve të përzgjedhur sipas njoftimit të datës 11.08.2017 për kandidatët e suksesshëm, dhe ka konstatuar se në bazë të të gjitha dokumentacioneve, kandidatët si në vijim:

- në bazë të Diplomës Universitare të datës 04.02.2016 ka diplomuar më datë 26.10.2015;
- në bazë të Diplomës Universitare të datës 28.07.2015 ka diplomuar më datë 24.06.2015;
- në bazë të Diplomës Universitare të datës 26.07.2016 ka diplomuar më datë 19.07.2016;
- në bazë të Diplomës Universitare të datës 17.10.2016 ka diplomuar më datë 14.10.2015,;
- në bazë të Diplomës Universitare të datës 02.07.2015 ka diplomuar më datë 16.10.2014;
- në bazë të Diplomës Universitare të datës 02.06.2015 ka diplomuar më datë 08.10.2014;
- nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit;
- nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit;
- nuk ka dëshmi për përvojë pune tri (3) vite pas diplomimit;
- nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit;
- nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit;
- nuk ka ofruar dëshmi të përvojës së punës tri (3) vite pas diplomimit;

nuk i plotësojnë kriteret e konkursit sepse deri në momentin e përgatitjes së listës së shkurtër (28.06.2017) nuk e kanë përvojën e punës tri (3) vite pas diplomimit, andaj Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes në listën e shkurtër, respektivisht përzgjedhjes së kandidatëve të lartcekur ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.2. përvoja e punës"* dhe nenit 17 paragrafit 2 nën paragrafit 2.9 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil i cili përcakton se: *"Karakteristikat e nivelit profesional tre (3) janë: Kërkon njohuri të thella dhe të specializuara të fituara përmes shkollimit universitar, trajnimeve përkatëse dhe së paku tri (3) vite përvojë pune"*, çka nënkupton se e gjithë përvoja e punës në rastin konkret duhet të jetë fituar pas shkollimit universitar sepse kjo është e ndërlidhur me parimin e profesionalizimit i përcaktuar me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sa i përket vlerësimit të përvojës së punës pas diplomimit, siç theksohet në Aktgjykimin A.nr.810/18 të datës 22.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.193/18 të datës 27.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, përveç depozitave ligjore në fuqi respektivisht nenit 11 Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe dispozitave të nenit 17 paragrafit 2 nën paragrafit 2.9 të Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin

Civil, i është referuar Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se për pozita profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit, andaj bazuar edhe në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në gjetjet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, sipas Aktgjykimit AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 dhe Aktgjykimit AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022, konstaton se kandidatët që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit, konkretisht atë të përvojës së punës pas diplomimit duhet të largoj nga lista përfundimtare konkretisht Njoftimi për kandidatët e suksesshëm të datës 11.08.2017, ndryshohet tek kandidatët që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit dhe ndryshimi bëhet në kuptim të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulohë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala”*.

Pa ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrës se Vendimit me Nr.01/2018 i datës 10.01.2018 të njëjtin nuk e ka arsyetuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, po ashtu nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sipas dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, andaj në kuptim të nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ky vendim ndryshohet, bazuar në vërejtje e dhëna sipas Aktgjykimit AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 dhe Aktgjykimit AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke marr parasysh që Këshilli për këtë çështje ka pas vlerësim ndryshe.

Sipas atyre që u thanë më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, këtë rast e ka vendosur duke u bazuar në Aktgjykimin AA.nr.401/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.402/20 të datës 16.06.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative të cilat e kanë detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të vendos në këtë frymë.

Andaj nga konstatime e këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, është i obliguar që të zbatoj këtë vendim, dhe të bëjë ndryshimin e Njoftimit për kandidatët e suksesshëm të datës 11.08.2017 në pajtim me këtë vendim.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.616/2022

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesve
- Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

